

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, përmes gjyqtarës Mevlide Shabani, me bashkëpunëtorën profesionale Vlora Selmani - Rahimi, në çështjen juridiko-civile të paditësve: Sh. K, Z. K. dhe Sh. Ki nga Gj., rruga „ S. Ç.,nr.35 te cilët i përfaqëson sipas autorizimit juristi E. H nga Gj, kundër të paditurve: A. B, A. B1, B. B, S. B, Y. B, S. H.-B., F. L. B, M. I –B që të gjithë nga Gj rruga „S Ç., nr., për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, në seancën kryesore dhe publike të mbajtur më dt.09.08.2016 bie këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: Sh K, Z. K. dhe Sh. K. nga Gj, e ushtruar kundër të paditurve A. B A.B. B B, S B, Y B, S. H.-B, F. L B, M. I –B dhe **VËRTETOHET**, se paditësit janë pronar të ngastrave të reja K me sa vijon edhe atë :

Paditësi: **Z. K**, është pronar në ngastrën e re Knë sipërfaqe të përgjithshme prej 216m² me kulturë oborr ne vendin e quajtur „ „ZK Gj

Paditësi: **Sh. K**. është pronar në ngastrën e re K..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 254m² me kulturë oborr ne vendin e quajtur „ „ZK .Gj

Paditësi: **Sh K** është pronar në ngastrën e re Kadastrale, në sipërfaqe të përgjithshme prej ..m² me tokë ndërtimore ne vendin e quajtur „ „ZK. Gj, që të gjitha pjesë e parcelës me numër të vjetër 2361-5 e cila evidentohet në emër të A. B. me sipërfaqe të përgjithshme prej m2 , si dhe parcelës me numër, e cila evidentohet ne emër të Z. B. sipërfaqe të përgjithshme prej ... m2 të cilat parcela mbajnë numrin e përkohshmeme sipërfaqe të përgjithshme prej ...m2.

Ndërsa parcela e re me numërnë sipërfaqe prej ...m², e cila shfrytëzohet si rrugë private mbetet në bashkëpronësi ideale të paditësve Z. K. 1/3, Sh. K. 1/3 dhe Sh. K.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës, kurse paditësit janë të detyruar që në mënyrë të barabartë kësaj gjykate t'ia paguajnë shumën e të hollave në lartësi prej 50€, në emër të përpilimit të këtij aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, duke u bazuar në vlerën e kontestit, konform Udhëzimit Administrativ për Unfikimin e Taksave Gjyqësore.

A r s y e t i m

1.Kompetenca e gjykatës:

Kompetenca territoriale e gjykatës është përcaktuar në bazë të nenit 41.1 të LPK, lidhur me kompetencën territoriale ekskluzive, meqë paluajtshmëria kontestuese gjendet në territorin e

Gjykatës Themelore në Gjilan, kurse kompetenca lëndore është përcaktuar në bazë të nenit 29 të LPK.

Paditësit Sh. K., Z. K. dhe Sh. K. nga Gj. të përfaqësuar nga juristi i diplomuar E .H nga Gj, në gjykatë kanë paraqitur padi më datë,15.02.2013,me bazë kontesti vërtetimi i pronësisë, kundër të paditurve A. B A. B,R. B,S B,Y. B, S. H. F. L. B, M. I. –B, ndërsa me date ...ka bërë prezicizimin e padisë në kuptim subjektiv dhe objektiv, pasi që i padituri i tretë R. B kishte vdekur me datë....., ndërsa tani si i paditur do të jetë trashëgimtari i tij – djali B. B .

Pas pranimit të padisë, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palëve të paditura ju ka dërguar padinë ,me date....., në mënyrë që të njejtit të paraqesin përgjigje në padi, ku të paditurit, kanë dhënë përgjigje në padi, duke e pranuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar.

Në seancën përgaditore të datëskanë prezentuar paditësit me përfaqësuesin e tyre sipas autorizimit E.H. dhe të paditurit A.B.dhe B. B, ndërsa të paditurat S, S M dhe Y. kanë munguar edhe pse ftesën e kanë pranuar në mënyrë të rregullt, me kërkesën e përfaqësuesit të paditësve seanca është mbajtur në mungesë të tyre.

Ne shqyrtimin gjyqësor, përfaqësuesi i paditësve ka deklaruar, se mbetet në tërësi pranë padisë, dhe kërkesëpadisë së precizuar të datës duke i propozuar gjykatës që të dalin në vendin e ngjarjes me ekspertë gjeodet me qëllim që të vërtetohet gjendja faktike e palujtshmerisë, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas daljes së ekspertëve gjeodet në e vendin e ngjarjes është vërtetuar gjendja faktike dhe reale në teren , ashtu që ka bërë ndyshimin e petitumit të padisë që i njejtë petitum të jetë sipas konstatimit të ekspertizës nga ana e ekspertëve gjeodet meqenëse paditësit i shfrytëzojnë të pa penguar parcelat e tyre kadastrale me nr , me sipërfaqe prej ... , dhe parcela në sipërfaqe prej .., të bashkohen dhe të marrin numrin me sipërfaqe të përgjithshme prej dhe nga kjo ngastër formohen parcela të reja , ashtu që paditësi Z. K. të jetë shfrytëzues i parcelës së re me nr. -Inë sipërfaqe prej paditësi Sh. K të jetë shfrytëzues ...me sipërfaqe prej .. dhe paditësi Sh. K të jetë shfrytëzues i parcelësme sipërfaqe prej .., pasi që në këto parcela kanë ndërtuar edhe shtëpi banimi , ndërsa parcela e re me numër ...në sipërfaqe prej ...të shfrytëzohet si rrugë private dhe të jetë në bashkëpronësi të tre paditësve Z. K , Sh dhe Sh. K. të pjesës ideale.

I padituri A. B në seancën e shqyrtimit përgaditor të datës, ka deklaruar se nuk e kundërshton kërkesëpadinë e paditësve pasi që babai i tij i ndjerë Z. B në vitin ja kishte shitur palujtshmerinë në fjalë babait të paditësve N. K , duke shtuar se ka qenë prezent kur është bërë shitblerja e kësaj ngastre dhe se për këtë palujtshmeri nuk kanë përpiluar kontratë me shkrim por vetëm me gojë dhe menjëherë pas blerjes së shtëpisë familja e tani paditësve kishte hyrë në shfrytëzim të kësaj ngastre.

I padituri B. B në seancën e shqyrtimit përgaditor të datës ka deklaruar se nuk e kundërshton kërkesëpadinë e paditësve, duke cekur se qëndron pas deklaratës se babit të tij të ndjerë R.B të dhënë në gjykatë me datë dhe i përkrahur në tërësi fjalët e axhës së tij A. se si është bërë shitblerja, duke shtuar se paditësit këtë palujtshmeri e shfrytëzojnë që nga vitet e 70-ta,ashtu që gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësve në tërësi ta aprovoj si të bazuar.

4.Provat e administruara në shqyrtimin kryesor:

Çertifikata mbi të drejtën e pronës me numër të njësisë ...të datës....., certifikata mbi të drejtën e pronës me numër të njësisë e datës....., si dhe ekspertiza e ekspertëve gjeodet e datës....., se bashku me skicat

6. Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës:

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk janë kontestuese faktet se paditësit Sh. K , Z. K dhe Sh. K janë trashëgimitarët në shfrytëzimin e kësaj palujtshmerie të cilën ua kishte blerë babai i tyre i ndjerë N. Knë vitin , prej babait të paditurve tani i ndjerë Zenel Buca .

Nuk është kontestues fakti se i padituri A. B dhe trashëgimtari i të ndjerit R.B djali i tij B.Bsepse që të dy të paditurit nuk e kanë kontestuar këtë shitblerje të palujtshmerisë që nga viti 1976 , ku kanë theksuar faktin se paditësit në fjalë palujtshmerinë në fjalë e shfrytëzojnë të papenguar nga askush.

Kontestues ishte fakti i ndarjes së parcelave në bazë gjeometrike mirëpo pas daljes së gjykatës me datënë vendin e ngjarjes si dhe ekspertëve gjeodet të njëjtit kanë konstatuar këtë gjendje faktike lidhur se parcela ka qenë e evidentuar në emër të A.B në sipërfaqe prejGjilan me kulturë arë në vendin e quajtur..., ndërsa parcelaështë evidentuar në emër të në sipërfaqe të përgjithshme prej me kulturë oborr , ndërsa pas vendimit të plotfuqishëm të gjykatës këto parceladhedhe kjo parcelë pas bashkimit kjo lëndë ka marr numrin ...me sipërfaqe prej dhe këtë parcelë në bazë të gjendjes faktike Z , Sh dhe Sh K këtë parcelë e kanë në shfrytëzim ndërsa sa i përket paditësit Z. K ka theksuar se i njëjti është shfrytëzues real i ngastrës K në sipërfaqe të përgjithshme prej me kulturë tokë ndërtimore ne vendin e quajtur Gj paditësi Sh. K është shfrytëzues real në ngastrën në sipërfaqe të përgjithshme prej ...me kulturë tokë ndërtimore ne vendin e quajtur „dhe paditësi Sh. K është shfrytëzues real në ngastrën K ...në sipërfaqe të përgjithshme prej ... me tokë ndërtimore ne vendin e quajtur ,,.....

Nga certifikatat mbi të drejtat e pronës me numër të njësisëtë datës....., si dhe certifikata mbi të drejtën e pronës me numër të njësisë ...e datës.....,si dhe ekspertiza e ekspertëve gjeodet e datës....., se bashku me konstatimin dhe skicat ...nga vendi i ngjarjes gjykata vertetoi faktin se parcela me numër Gj, evidentohet në emër të A. B në sipërfaqe prej ... ZK Gj me kulturë arë në vendin e quajtur I. P , ndërsa parcela ...është evidentuar në emër të Z. B në sipërfaqe të përgjithshme prej me kulturë oborr , dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike do të bashkohen sipas kornizës për matje gjeodezike dhe do të marrin numerin e fudnit to Z K Gjilan me nr.5174-0 me sipërfaqe të përgjithshme ... ne bazë të gjendjes faktike paditësit Z. , Sh dhe Sh.K nga kjo parcelë janë duke e shfrytëzuar Z. K e shfrytëzon parcelën e renë sipërfaqe të përgjithshme prej ... e cila shfrytëzohet si oborr , ka të ndërtuar një objekt banimi individual, paditësi Sh.K është shfrytëzues real në ngastrën Kadastrale, në sipërfaqe të përgjithshme prej me kulturë oborr ne ka te nertuar nje objekt banimi individual dhe paditësi Sh. K është shfrytëzues real në ngastrën Kadastrale..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 304m²e cila shfrytëzohet si oborr P+I+NK , ndërsa parcela 5174-4 në sipërfaqe prej 70m² të shfrytëzohet si rrugë private dhe është në bashkëpronësi të tre paditësve Z. K. 1/3 , Sh. K. dhe Sh. K1. të pjesës ideale, të gjitha ne vendin e quajtur ,,Gj

Gjykata vërtetoi se kontrata gojore e lidhur në Korrik të Vitit 1977 në mes të babait të paditësve N, K. blerës dhe babait të paditurve Z.B si shitës, edhe pe nuk është lidhur në formën e parëparë me ligj ,e njëjta si e tillë prodhon efekt të plotë juridik e aq më tepër kur është përmbushur në tërësi nga kontraktuesit në bazë të dispozitës së nenit 73 të LMD-së, kontrata është e vlefshme nëse detyrimet që rrjedhin nga ajo në mes të palëve kontraktuese, janë përmbushur në tërësi.

Gjykata ka vendosur që secila palë ti bart shpenzimet e veta procedurale ti bartin secila palë veq e veq, konform nenit 450 të LPK, ndersa ka obliguar paditesit që të paguajnë shumën e të hollave në lartësi prej 50€, në emër të përpilimit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në vlerën e kontestit, konform Udhëzimit Administrativ për Unfikimin e Taksave Gjyqësore.

Nga arsyet e cekura më lartë, e bazuar edhe në nenin 143 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Më datë 09.08.2016

Gjyqtarja ,
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit, ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.

